



Emri i Stacionit:

I licencuari i regjistruar:

Nr. i Indeksit të Mediave:

Data:

DËSHMIA E PRONËSISË

KPM-së i duhet që të ketë informacionin aktual për pronësinë dhe regjistrimin e stacioneve të radiove dhe televizioneve të licencuara në Kosovë. Ju lutemi plotësoni këtë formular dhe paraqiteni informacionin e kërkuar brenda 10 ditë-pune nga data e marrjes.

Termi “Pronar” tregon personin apo grupin e personave, OJQ-të apo bizneset private që posedojnë pajisjet e stacionit transmetues, përfshirë këtu pajisjet e studios, aparatit transmetues, antenën dhe/apo ndërtesën ku është i vendosur transmetuesi.

Termi “I licencuar” tregon emrin e emiterit të radios ose televizionit të cilit KPM-ja i ka lëshuar Licencë dhe përdorimit të frekuenc-ës(-ave) radiodifuzive që shoqëro-n(-jnë) atë.

Ju lutemi përgjigjuni pa rezerva pyetjeve të mëposhtme:

1. Emri i të licencuarit:

2. Statusi ligjor i të licencuarit: [Shënoni njërin prej tyre]

- a. Person fizik;
- b. Organizatë joqeveritare (OJQ);
- c. Biznes komercial.

3. Nëse i licencuari është person fizik:

- a. Ju lutemi shënoni nëse ky person është drejtori i stacionit, dhe nëse jo, kush është drejtori në realitet.
- b. Ju lutemi shënoni nëse i licencuari është pronari i vetëm i stacionit;
- c. Nëqoftëse i licencuari ka vetëm një pjesë të interesave të pronësisë, ju lutemi identifikoni personat individualë ose njësitë e tjera që janë pronarë të ligjshëm të stacionit dhe lidhjen e tyre me Të Licencuarin.
- d. Ju lutemi të na jepni një kopje të Identifikimit personal të UNMIK-ut të të Licencuarit(-ve) individual(ë).
- e. Ju lutemi tregoni nëse i Licencuari individual mban gjithashtu ndonjë post të zgjedhur apo të emëruar në qeverinë qendrore apo atë lokale ose në organet ekzekutive të ndonjë partie politike.

4. Nëse i licencuari është Organizatë joqeveritare (OJQ):

- a. Ju lutemi shënoni emrin e plotë ligjor të OJQ-së, adresën e selisë së saj dhe një përshkrim të veprimtarive të saj në rast se ato nuk kufizohen vetëm në fushën e transmetimeve;
- b. Ju lutemi bashkangjitni një kopje aktuale të regjistrimit ligjor të OJQ-së;
- c. Ju lutemi shënoni emrat dhe adresat e anëtarëve aktualë të Bordit të Drejtorëve dhe tregoni cili prej tyre është Kryetari apo Presidenti i bordit dhe Zv. Kryetari apo Zv. Presidenti i bordit nëse ka të tillë.
- d. Ju lutemi shënoni nëse ndonjëri prej anëtarëve të bordit të OJQ-së mban gjithashtu ndonjë post të zgjedhur apo të emëruar në qeverinë qendrore apo atë lokale ose në organet ekzekutive të ndonjë partie politike. *[Shënim: Një përgjigje pozitive do të shkaktonte ndryshimin e licensës.]*

5. Nëse i licencuari është një Biznes komercial:

- a. Ju lutemi shënoni emrin e plotë ligjor të biznesit, adresën e selisë së tij dhe një përshkrim të veprimtarive të tij nëse ato nuk kufizohen vetëm në fushën e transmetimeve;
- b. Ju lutemi bashkangjitni një kopje të nostrifikuar të regjistrimit ligjor të biznesit;
- c. Ju lutemi shënoni emrat dhe adresat e anëtarëve të bordit të drejtorëve, pronarëve/zyrave të regjistruara të kompanisë apo mbajtësve të aksioneve nëse këto informata nuk gjenden në regjistrimin e biznesit.
- d. Ju lutemi tregoni nëse ndonjëri prej anëtarëve të bordit të kompanisë, drejtorëve, ose pronarëve të regjistruar mban gjithashtu ndonjë post të zgjedhur në qeverinë qendrore apo atë lokale ose në organet ekzekutive të ndonjë partije politike.
[Shënim: Një përgjigje pozitive do të shkaktonte ndryshimin e licencës.]

Jemi të gatshëm t'i përgjigjemi pyetjeve që mund të keni. Ju lutemi kontaktoni:

Naile Selimaj & Venera Buçaj
Departamenti i Licencimit në KPM
Rruga Gazmend Zajmi #1
Prishtinë

t. +381 (0)38 245 031
f. +381 (0)38 245 034
e. info@imc-ko.org

[Miratuar më: 25 prill 2005]